

FORMULARI PËR KËRKESË PËR PËLQIM MJEDISOR

Numri i lëndës				
Data e aplikimit	14.05.2025			
Emri i plotë i projektit për të cilin aplikohet	FABRIKENË PËR PËRPUNIMI DHE KONSERVIMIN E MISHIT ‘MISHTORE EGZONI’ SH.P.K. E VENDOSUR NE FSHATIN BELLOPOJË, KOMUNA E PEJËS			
Vlera financiare investuese e projektit (ne euro)	€	155,500.00 €		
Vlera e tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor (në euro)	€	300.00		
Dokumentet që dorëzohen bashkë me këtë kërkesë,			Po Jo	
	1. Raporti i VNM-së në katër (4) kopje, i nënshkruar nga bartësi dhe hartuesi i Raportit të VNM-s (pronarit të kompanisë së licencuar dhe personave të licencuar të kompanisë) dhe një (1) kopje në formë elektronike (CD).		Po	
	2. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës zonale, kushtet ndërtimore		Po	
	3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit		Po	
	4. Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme).		Po	
	5. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref		Po	
	6. Plani i rilevimit të terrenet nga Gjeodeti i licencuar		Po	
	7. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuesit për pëlqim mjedisor		Po	
	8. Fatura e pagesës së tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor, sipas udhëzimit administrativ Nr.08/2015		Po	
	9. Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit		Po	

FABRIKA PËR PËRPUNIMIN DHE KONSERVIMIN E MISHIT “MISHTORE EGZONI” sh.p.k

	11. Në rastin e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materje eksplozive: Pëlqimi nga Autoriteti kompetent për lejimin e vendosjes së rezervuarëve	Jo	
Emri dhe mbiemri i aplikuesit	Afrim Shkuliqi,		
Kompania	“MISHTORE EGZONI” sh.p.k		
Adresa e Kompanisë	Fshati Bellopojë, pa numër, Pejë		
Tel, fax, E-maili	+383 49 295 298 ntp.egzon@gmail.com		

Emri i Kompanisë:	“MISHTORE EGZONI” sh.p.k
Adresa:	Fshati Bellopojë, pa numër, Pejë
Tel:	+383 49 295 298
E-mail:	ntp.egzon@gmail.com



RAPORTI

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NE MJEDIS PËR FABRIKENË PËR PËRPUNIMI DHE KONSERVIMIN E MISHIT “MISHTORE EGZONI” SH.P.K. E VENDOSUR NE FSHATIN BELLOPOJË, KOMUNA E PEJËS

Pejë, Maj 2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

FABRIKA PËR PËRPUNIMIN DHE KONSERVIMIN E MISHIT “MISHTORE
EGZONI” SH.P.K, BELLOPOJË, PEJË

Aplikuesi: 'MISHTORE EGZONI' SH.P.K (<i>Investitor</i>) Përsone përgjegjës: Afrim Shkuliqi, Drejtor menaxhues Adresa: Fshati Bellopojë, Komuna Pejës Tel: +383 49 295 298 E-mail: ntp.egzon@gmail.com Nënshkrimi: _____ Datë: 14.05.2025	Hartuesi i raportit të VNM-së: Dr. Sc. Pajtim Bytyçi E-mail: pajtim.bytyqi@hotmail.com Tel: +383 44 766 442 Adresa: Prishtinë Nënshkrimi: _____ Datë: 14.05.2025
--	---

Pejë, Maj 2025

Përmbledhje:

1.	HYRJE	6
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së.....	6
3.	TË DHËNA PËR KOMPANINË	7
3.1.	Vendndodhja e Fabrikës.....	8
3.2.	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	10
3.3.	Procesi i therjes se kafshëve.....	11
3.4.	Objektet e thertores “Mishtore Egzoni” sh.p.k	17
3.5.	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit.....	20
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME	21
4.1.	Automatizimi i proceseve teknologjike	21
4.2.	Përdorimi i lëndëve të para miqësore me mjedisin	22
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	24
5.1.	Hidrografia.....	24
5.2.	Ndotësit Kryesor	25
5.3	Flora dhe Fauna	25
5.3.	Transporti rrugor.....	28
5.4.	Mbeturinat e ngurta.....	28
5.5.	Ndotësit nga burimet agro-kemikale.....	28
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	29
6.1.	Ndikimet në ajër.....	29
6.2.	Ndikimet në tokë.....	29
6.3.	Ndikimet ne ujë.....	30
6.4.	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	30
6.7.	Ndikimi mjedisor nga mbeturinat	31
6.8.	Trashëgimia Kulturore	32
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	32
8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE.....	34
9.	PËRSHKRIMI I MASAVE	36
9.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	36
9.3.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë.....	37
9.4.	Masat për mbrojtje nga zhurma	37
9.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	38
9.6.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	38

9.7.	Masat për menaxhimin e mbeturinave	38
9.8.	Masat rehabilituese	38
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	42
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	42
12.	PËRFUNDIM	43
13.	LITERATURA	45

Lista e figurave:

Figura 1.	Shtrija hapësinore e objektit e mishtores në komunën e Pejës	8
Figura 2.	Lokacioni i Kompanisë “MISHTORE EGZONI” sh.p.k	9
Figura 3.	Objektet e Kompanisë Fabrika për përpunimin dhe konservimin e mishit “MISHTORE EGZONI” sh.p.k	10
Figura 4.	Therja e kafsheve.....	11
Figura 5.	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura “Mishtore Egzoni” sh.p.k.....	13
Figura 6.	Mishi i ndare nga procesi teknologjik	15
Figura 7.	Objektet e fabrikës për përpunimin dhe konservimin e mishit “MISHTORE EGZONI sh.p.k.	20

Lista e tabelave:

Tabela 1.	Mbeturinat të cilat gjenerohen nga kompania.....	31
Tabela 2.	Komponentë mjedisorë, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve.....	39
Tabela 3.	Forma tabelare e kostos investive të kompanisë	44

1. HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është një dokument i rëndësishëm dhe i nevojshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë ku pas plotësimit të kushteve nga Pëlqimi Mjedisor, Investitori duhet të aplikojë pastaj për marrjen e lejeve të tjera për operimin e Fabrikës së Përpunimit dhe Konservimit të Mishit si dhe Therjen e Kafshëve. Përmes këtij Raporti të VNM -së do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mund të paraqiten në relacionin e Fabrikës së Përpunimit dhe Konservimit të Mishit si dhe therjen e kafshëve duke pasur parasysh mjedisin jetësor të ngushtë dhe të gjerë. Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis për fabrikën në fjalë, me objektet përcjellëse me të gjitha veprimtaritë punuese (shërbim, transport, deponim, përpunim dhe konservim të mishit etj.), në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për Fabrikën së Përpunimit dhe Konservimit të Mishit si dhe Therjen e Kafshëve “MISHTORE EGZONI” Sh.p.k., me lokacion në Bellopojë të Komunës së Pejës, është punuar duke u bazuar në projektin e ndërtimit, gjendjen aktuale të lokacionit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit të fabrikës si dhe dokumentit teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së të Fabrikës në fjalë, kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis deri në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së operimit sepse kompania tashme ka ndërtuar objektin.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e Fabrikës së Përpunimit dhe Konservimit të Mishit si dhe Therjen e Kafshëve me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas projektit të përfunduar, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 10:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;

- ✚ Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- ✚ Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- ✚ Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- ✚ Lligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina;
- ✚ Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233;
- ✚ Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102 ;
- ✚ Udhëzimet administrative:
 - ❖ UA_(MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor,
 - ❖ Udhëzim Administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikoj për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

3. TË DHËNA PËR KOMPANINË

Fabrika për përpunimin dhe konservimin **“MISHTORE EGZONI” Sh.p.k.**, ndodhet në pjesën jugore të territorit administrativ të komunës së Pejës afër rrugës Rajonale Pejë – Deçan. Mishtorja **“MISHTORE EGZONI” Sh.p.k.**, ka operuar që nga viti 1995, në Pejë, ndërsa Fabrika për përpunimin dhe konservimin e mishit është ndërtuar në vitin 2025, në fshatin Bellopojë, Komuna e Pejës që tani aktualisht është duke operuar.

Ky raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, përkatësisht në:

Shtojca I.

Paragrafi 7. Industria ushqimore,

Në paragrafi 28.4. Fabrikat për përpunimin e mishit

Po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të marrjes së masave të nevojshme për të minimizuar ndikimet negative në Mjedis. Fabrika për përpunimin dhe konservimin e mishit është ndërtuar në Parcelat me nr. 00049-2, 00155-9, 00155-11, 00881-19, Zona kadastrale Bellopojë, ku pronën është private dhe fabrika që është ndërtuar në vitin 2020.

3.1. Vendndodhja e Fabrikës

Objekti i Fabrikës së Përpunimit dhe Konservimit të Mëdhenë si dhe Thërritjes së Kafshëve ndodhet në ngastrat kadastrale me nr. 00049-2, 00155-9, 00155-11, 00881-19, Zona kadastrale Bellopojë. Kompania “MISHTORE EGZONI” Sh.p.k., ndodhet në pjesën jugore të territorit administrativ të komunës së Pejës afër rrugës Rajonale Pejë – Deçan.




Figura 1. Shtrirja hapësinore e objektit të mishtores në komunën e Pejës

FABRIKA PËR PËRPUNIMIN DHE KONSERVIMIN E MISHIT “THERTORE EGZONI” sh.p.k




Figura 2. Lokacioni i Kompanisë “MISHTORE EGZONI” sh.p.k






Figura 3. Objektet e fabrika për përpunimin dhe konservimin e mishit “MISHTORE EGZONI” sh.p.k

3.2. Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Me poshtë paraqesim përshkrimin e veçorive kryesore të fazës operative të Fabrikës për përpunimin dhe konservimin e mishit nga kompania “**MISHTORE EGZONI**” Sh.p.k.

Për momentin kjo kompani bën therjen e kafshëve për përpunimin e mishit, konservimin e tij si dhe shitjen e tij me pakicë në pikë e shitjes në Pejë në mishtore.

Kapaciteti maksimal i therjes është 5 copë/jave, kompania mesatarisht realizon 2-5 therje në javë, përpunon dhe konservon rreth 1 tonë mish në javë.

Me kafshë për therje furnizohet nga tregjet vendore por edhe kafshë të importuara nga jashtë, e kryesisht nga Kroacia, Rumania, Hungari etj.

Përveç kafshëve si komponentët kryesore komponentët ndihmës janë:

- Energjia elektrike,

- Uji për nevoja të pastrimit dhe nevoja sanitare.

3.3. Procesi i therjes së kafshëve



Figura 4. Therja e kafshëve

Llojet e thertoreve dhe kërkesat për ndërtimin e tyre.

Thertoret sipas organizimit të punës ndahen në:

Thertoret publike shfrytëzohen nga të gjithë prodhuesit e mishit në një ndarje administrative dhe menaxhohen nga pushteti lokal.

Thertoret e fermave ndërtohen nga vetë fermerët, pranë fermave të mëdha për prodhimin sa më ekonomik të mishit.

Thertoret industriale janë objekte moderne për prodhimin e mishit, në të cilat procesi teknologjik i therjes së kafshëve është i mekanizuar ose i automatizuar.

Kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësojnë thertoret janë të përcaktuara në legjislacionin veterinar dhe të ushqimit.

Ndërtimi i thertoreve duhet të bëhet sipas kërkesave të mëposhtme:

Zgjedhja e vendit për ndërtimin e thertoreve

Thertoret ndërtohen në toka solide dhe të kulluara, duke mënjanuar terrenet me lagështi ose me rrezik rrëshqitjeje. Toka e parashikuar për ndërtim të thertoresh duhet të ketë hapësira të

mjaftueshme edhe për ndonjë zgjerim në të ardhmen. Thertorja duhet të zerë deri në 30% të sipërfaqes së truallit të përdorur për ndërtimin e saj dhe të jetë afër infrastrukturës rrugore.

Furnizimi me ujë

Thertorja duhet të ketë furnizim të vazhduar me ujë të pijshëm. Nevojat për ujë në thertore sipas studimeve llogariten që për çdo gjedh të therur të përdoren 500-1000 litra ujë. Për çdo derr 300-400 litra ujë dhe për çdo dele deri 200 litra ujë.

Për njerëzit që punojnë në thertore nevojitet deri 60 litra ujë/për çdo person/ditë.

Furnizimi me energji

Konsumi i energjisë në thertore është i lartë dhe sigurohet nga rrjeti energjetik. Energjia shfrytëzohet për ndriçim, ftohje, ngrirje, ngrohje uji, prodhim avulli etj.

Ndriçimi dhe ventilimi

Thertorja duhet të ketë hapësira të ndriçuara mirë, me burime drite me intensitetin e duhur. Si ndriçim artificial, në hapësirat e thertores, shfrytëzohet drita difuze me ngjyrë të bardhë, e cila siguron një mjedis normal pune.

Në hapësirat ku shfrytëzohet uji i ngrohtë dhe ka avullim të lartë, në hapësirat ku çlirohen aroma të pakëndshme gjatë punës, në vendet ku punojnë shumë punëtorë – duhet të sigurohet ventilim natyror ose artificial. Në vendet ku ka dalje gazesh, duhet të vendoset pajisje thithëse. Pikat e furnizimit me ajër të freskët, duhet të jenë të pajisura me filtra dhe rrjeta mbrojtëse, për të mos hyrë insektet dhe brejtësit.

Ndërtimi i ambienteve dhe pajisjeve për mbajtjen e kafshëve

Në thertore ndërtohen stalla që shërbejnë për pushimin e kafshëve para therjes, të cilat duhet të kenë pajisje për dhënien e ushqimit dhe të ujit të kafshëve të ardhura për therje. Shkarkimi i ujërave dhe mjediset jashtë thertores

Për të shmangur burimet e ndotjes, **në thertore duhet të planifikohen shkarkimet e ujërave që vijnë nga aktiviteti në thertore,** si dhe largimi i tyre në rrjetin e shkarkimit të ujërave të zeza.

Kompania “**Mishtore Egzoni**” shpk., ka ndërtuar impiantin e trajtimit të ujarëve që para shkarkimit në rrjetin e kanalizimit publik, ujerat se pari trajtohen e më pas shkarkohen në konform ligjeve dhe udhëzimeve administrative të Republikës së Kosovës.



Figura 5. Impianti i trajtimit të ujarëve të ndotura “Mishtore Egzoni” sh.p.k

Ndarja e ambienteve sipas proceseve që aplikohen në thertore
Kafshët e transportuara në thertore i nënshtrohen therjes sipas këtyre hapave:

Pranimi i kafshëve në thertore dhe pushimi i tyre para therjes

Marrja në dorëzim e kafshëve bëhet duke kryer peshimin, vlerësimin cilësor konform standardeve dhe kontrollit veterinar. Pas kontrollit, kafshët sistemohen në stalla të ndara në bokse sipas llojit të bagëtive.

Stallat duhet të jenë të pastra, me kanalizime shkarkimi dhe kushte optimale temperature.

Kafshët mbahen në stallë për tu çlodhur dhe pastaj i nënshtrohen periudhës së urisë.

Koha e qëndrimit para therjes për bagëtitë e trasha është 24-36 orë në varësi të mundimit fizik, për bagëtitë e imta është 12-24 orë në varësi të moshës, peshës trupore dhe mundimit fizik.

Kafshëve në periudhën e urisë u ndërpritet ushqimi dhe u jepet ujë, i cili ndërpritet 2-3 orë para therjes.

Kafshët lahen paraprakisht me ujë të bollshëm. Derrat lahen në të gjithë sipërfaqen trupore, kurse për gjedhin dhe bagëtitë e imta lahen thundrat dhe këmbët. Ky proces kryhet që të ulet

shkalla e kontaminimit të mishit gjatë procesit të therjes nga papastërtitë e ndryshme që ndodhen në trupin e tyre.

Trullosja e kafshës

Para therjes kafshët i nënshtrohen procesit të trullosjes, i cili ka për qëllim që kafshët të humbasin ndjenjat dhe të mos reagojnë me veprime të dhunshme në momentin e therjes. Gjatë këtij procesi, duhet që kafsha të mos humbasë funksionin e zemrës dhe të organeve të frymëmarrjes, pasi pengohet procesi i c'gjakësimit, duke bërë që të ulet cilësia e mishit. Trullosja kryhet me këto mënyra:

Trullosje mekanike, konsiston në goditjen e kafshës me pishtole në pjesën e prapme të kafkës.

Ç'gjakësimi

Ky proces kryhet duke bërë prerjen e venës dhe atë të arteries karotis, në vendin ku dalin nga kaviteti torakal. Qëllimi i çgjakësimit është largimi i gjakut, pasi qëndrimi i tij në mish bëhet burim i kontaminimit, pasi dihet që gjaku është një mjedis shumë i përshtatshëm për zhvillimin e mikroorganizmave.

Ç'gjakësimi kryhet në dy pozicione: në pozicionin horizontal dhe vertikal. Më i përshtatshëm është pozicioni vertikal, pasi arrihet një shkallë ç'gjakësimi më e mirë. Koha e c'gjakësimit është e ndryshme, në varësi të llojit të kafshës. Për gjedhin ajo nuk duhet të jetë më pak se 6 minuta dhe jo më tepër se 20 minuta. Mbajtja për një kohë të gjatë do të shkaktojë largimin e një sasive të madhe gjaku, i cili do të sillte si pasojë çngjyrosjen e mishit, duke ulur intensitetin e ngjyrës. Koha e c'gjakësimit të derrave është jo më pak se 6 minuta dhe jo më tepër se 12 minuta, kurse për bagëtitë e imta kjo kohë varion nga 5-10 minuta.

Heqja e kokës

Pas ç'gjakësimit fillon zbardhimi (rrjepja), duke e hapur lëkurën në mesin e nofullave të poshtme dhe pastaj në gjithë kokën. Më pas bëhet shkeputja e saj nga trupi mbi artikulacionin bashkues.

Për gjedhin dhe bagëtitë e imta, pas heqjes së kokës bëhet prerja e brinjëve me hanxhar ose me sharrë disk. Pastaj koka varet në stativ me çengela, ku shoqërohet me numrin rendor, i cili i

korrespondon numrit të trupit ose karkasës. Kokët e vendosura në stativ i nënshtrohen inspektimit veterinar.

Heqja e lëkurës nga kafshët e trasha

Në procesin manual, pas largimit të kokës bëhet zbardhimi i gjymtyrëve të para dhe shkëputja e ekstremiteteve të përparme që përpunohen me tej në seksionin e nënprodukteve. Pastaj bëhet rrjepja e gjymtyrëve të pasme duke nxjerre në dukje tendinin e Akilit, ku vendoset cengeli dhe me një pajisje ngritëse trupi i kafshës së therur varet në linjë ajrore, e cila është e instaluar në thertore.

Në zhveshjen e mekanizuar, trupi qëndron i varur në konvejerin ajror, i cili është i siguar me shirita metalike që të mos rrëshqasë nga linja. Këmbët e përparme fiksohen nëpërmjet dy ganxhave metalike në bazamentin e fiksuar në dysHEME, kurse lëkura e këmbëve lidhet me zinxhirë, të cilët kapen në ganxhën e ngritësit (vinçit ose cikrikut) të mekanizuar.



Figura 6. Mishi i ndare nga procesi teknologjik

Një nga kërkesat për prodhimin e mishit është edhe heqja e organeve të brendshme kur trupi i kafshës i zhveshur nga lëkura është në gjendje të varur. Nxjerrja e organeve të brendshme fillon

me heqjen e organeve seksuale, shkëputjen e zorrës së trashë, fshikëzës së urinës dhe vazhdon me largimin e kompletit të zorrëve dhe stomakut. Gjatë këtij procesi tregohet kujdes i veçantë që zorrët të mos priten me thikë, për të evituar daljen e lëngjeve të zorrëve që shkaktojnë ndotjen e mishit.

Pas kësaj, behet çarja e dërrasës së krahavorit, për largimin e mëlçisë, shpretkës, zemrës, mushkërive dhe trakesë. **Tek bagëtitë e trasha dhe derrat** këto organe lihen te varura ne trup, **kurse tek bagëtitë e imta** ato shkëputen dhe vendosen nëpër stativë për t’u kontrolluar nga veterineri. Komplet i zorrëve dhe aparati tretës vendoset në tavolina, kontrollohet, pastrohet dhe më pas dërgohet për përpunim.

Sharrimi i trupave

Sharrimi i karkasave lehtëson transportin e trupave të therur dhe përshpejton proceset e ftohjes, ngrirjes dhe sistemimit të tyre gjatë ruajtjes në gjendje të ngrirë. **Karkasat e derrave ndahen në dy pjesë simetrike** me sharrë elektrike, ose në mungese të saj me hanxhar. Procesi fillon nga lart poshtë duke ndarë shtyllën kurrizore në dy pjesë të barabarta, me palcën kurrizore nga njëra anë. Mishi i bagëtive të trasha trup ndahet në katër pjesë simetrike; fillimisht në dy pjesë dhe pastaj secila ndahet përgjysmë duke e bërë prerjen midis dy brinjëve të fundit.

Viçat me peshë të vogël nuk ndahen në katër pjesë, por në dy pjesë, ashtu si derrat. Mishi i bagëtive te imta nuk ndahet, por lihet trup.

Kontrolli dhe inspektimi veterinar

Ky proces konsiston ne kontrollin e mishit te kafshëve, që mund të jenë të prekura nga sëmundje te ndryshme. Kontrolli veterinar bazohet në simptomat e ndryshme që shfaqen nga kafshët e therura gjatë kontrollit të organeve të brendshme, si të mëlçisë, zemrës, mushkërive dhe vete karkases. Mishi kontrollohet edhe për abscese dhe në rastet e pranisë së tyre largohet ajo pjesë që është kontaminuar. Po kështu, kur mishi gjatë kontrollit konfirmohet se është i prekur nga sëmundje të ndryshme, ai veçohet dhe sipas vlerësimit të mjekut veteriner dërgohet në trajtime të mëtejshme specifike. Pas kontrollit veterinar, mishi vulozet nga mjeku veteriner dhe vlerësohet nga teknologu i cilësisë së mishit, sipas standardeve në fuqi, si dhe përcaktohet destinacioni i duhur.

Tualeti i thatë dhe i njomë i karkasave

Tualeti i thate konsiston në largimin e dhjavit të barkut, pjesëve të gjakosura, gjëndrave të papërdorshme si ushqim, abscese, mbeturinave të mishit të diafragmës, mbetjeve të trakesë, ezofagut etj. **Për kafshët e trasha**, tualeti i thatë vazhdon edhe me largimin e bishtit.

Tualeti i njomë kryhet gjithmonë pas atij të thatë. Ky proces kryhet duke larë mishin në dush me ujë të freskët dhe të ftohtë (10-15°C), me qëllim që të largohen të gjitha papastërtitë dhe pjesët e gjakut që ndodhen në sipërfaqe. Tualeti i njomë shpejton uljen e temperaturës së mishit të porsa therur. Duhet pasur kujdes që pas tualetit të njomë, karkasat e derrave të fshihen me leckë dhe të thahen me ventilim, sepse lagështia e mbetur rrezikon prishjen e mishit.

Qëndrimi dhe peshimi

Pas përfundimit të procesit të therjes karkasat duhet të qëndrojnë patjetër në temperaturën e ambientit në vende të caktuara për rreth 2-6 ore për arsye teknologjike, si:

Të bëhet kullimi i mishit nga mbetjet e gjakut, lëndet organike etj.

Te ulet temperatura e mishit afërsisht në temperaturën e ambientit

Nuk lejohet futja e mishit të porsa therur në frigorifer, sepse ndryshimi i madh i temperaturave midis ambientit dhe mishit rrit shkëmbimin e nxehtësisë, dhe si pasojë procesi i avullimit të ujit nga mishi do të jetë shumë i madh. Si rezultat, uji do të kondensohet në sipërfaqen e mishit, duke sjellë pasoja të tilla si jargosen e mishit gjatë ruajtjes.

Dy orë pas therjes fillojnë ndryshimet autolitike në mish, si rezultat ulet pH deri në vlerën 5.4 dhe pas kësaj fillon periudha e tkurrjes muskulare dhe shkaktohet rritja e fortësisë së mishit.

Në mishin e gjedhit, dhenve dhe dhive duhet të formohet cipa e tharjes në sipërfaqe, para se të kalojë në procesin e ftohjes. Mishi që do të përpunohet pas formimit të cipës tharëse kalon nën procesin e ftohjes.

3.4. Objektet e thertoresh “Mishtore Egzoni” sh.p.k

Në vijim të këtij raporti të VNM-së, do të paraqiten disa objekte të Fabrikës për përpunimin dhe konservimin e mishit “MISHOTRE EGZONI” SH.P.K dhe atë:







Figura 7. Objektet e fabrikës për përpunimin dhe konservimin e mishit “MISHTORE EGZONI sh.p.k.

3.5. Përlogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit

Me poshtë do ti përshkruajmë të gjitha emetimet e pritura gjatë fazës së operimit:

Uji: Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës së kompanisë nuk ka pësuar ndryshime dhe nuk ka ndikuar negativisht ku ndotja është minimale, fabrika në fjalë ka ndërtuar sistemin gypor të largimit të ujërave atmosferik dhe ujërat nga procesi i prodhimit, konservimit dhe therjes së kafshëve mblidhen dhe trajtohen në impiant, ndërsa ujërat fekal edhe pse sasia e ujërave të shkarkuara fekale është shumë e vogël shkarkohen në rrjetin e kanlizimit të fshatit. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për pastrim të mishit/kafshës së therur dhe gjakut të saj, për proces të prodhimit si dhe të pastrimit të dyshemesë, për nevojat e tualeteve si dhe nevojat e pastrimit të makinerive. Ndikimi kryesor i ndotjes së ujërave janë shkarkimet e ujërave të pa trajtuara por zona ku është e ndërtuar fabrika e kompanisë shkarkohet në kolektorin kryesor i cili pastaj shkarkohet në impiantin kryesor të qytetit për trajtim.

Ajri: Ky aktivitet nuk parasheh përdorimin e lëndëve djegëse, procesi teknologjik i prodhimit nuk paraqet rrezik potencial për ndikim në ajër, ndotja e ajrit mund të vijë nga lëvizja e makinave që lëvizin në rrugën rajonale në afërsi të fabrikës.

Dheu – duke konsideruar kapacitetet e projektuara, si dhe si rezultat i investimit adekuat – kontakti i ujërave nga brenda lokacionit të projektit me ujërat sipërfaqësore është izoluar - mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën të janë minimale.

Zhurma – gjate operimit mund të ketë zhurmë gjate lëvizjes së makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjate operimit është minimale.

Dridhjet – Dridhjet të tokës, tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim.

Drita, nxehtësia dhe rrezatimi – Janë tri dukuri që së bashku të ndihmojnë në realizimin e punës ku është ndërtuar objekti të cilin e shfrytëzon kompania “Mishtore Egzoni” Sh.p.k. ka drite, rrezatim diellor i cili ndihmon në kursimin e energjisë elektrike.

Flora dhe Fauna – Nuk janë të atakuar nga ky aktivitet nga shkarkimi i ujerave, sepse kompania ka ndërtuar impiantin e trajtimit të ujerave, ndërsa sa i përket emetimit të gazrave në ajër, nuk ka emetime të gazrave në ajër nga ky aktivitet.

Ndikimet sociale dhe ekonomike – mund të themi lirisht se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal.

Përkundrazi, priten efekte pozitive, ku pritet të rritet nr. i të punësuarve. Ky Projekt ka ndikuar pozitivisht në ekonominë Vendore dhe lokale.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME

Për të siguruar që projekti i fabrikës për përpunimin, konservimin e mishit kompania "Mishtore EGZONI" Sh.p.k., të jetë i suksesshëm dhe i qëndrueshëm, është e rëndësishme të shqyrtohen disa alternativa të arsyeshme. Këto alternativa ndihmojnë në vlerësimin e skenarëve të ndryshëm operativë dhe zgjedhjen e metodave më të mira për të përmirësuar efikasitetin, koston dhe ndikimin mjedisor. Përshkrimi i alternativave të arsyeshme për funksionimin e një fabrike që prodhon, konservon mish dhe therë kafshë mund të përfshijë opsione të ndryshme që ndihmojnë në përmirësimin e proceseve të prodhimit, rritjen e efikasitetit, përmirësimin e cilësisë dhe uljen e kostove. Më poshtë janë disa alternativa të mundshme që mund të merren në konsideratë për të optimizuar funksionimin e një fabrike të tillë:

4.1. Automatizimi i proceseve teknologjike

Zbatimi i sistemeve të automatizuara në proceset e prodhimit për të përmirësuar efikasitetin dhe ulur gabimet njerëzore.

Avantazhet: Rrit prodhimin, redukton kostot e punës, përmirëson saktësinë dhe konsistencën e produktit,

Disavantazhet: Investime të larta fillestare për pajisjet dhe mirëmbajtjen e sistemeve automatike.

4.2. Përdorimi i lëndëve të para miqësore me mjedisin

Zëvendësimi i materialeve tradicionale me materiale biodegraduese ose të riciklueshme gjatë procesit të prodhimit dhe konservimit të mishit.

Avantazhet: Përputhje me standardet e mjedisit dhe kërkesat e konsumatorëve të ndërgjegjshëm për çështjet ekologjike, përmirësim i imazhit të brendeve të prodhuara,

Disavantazhet: Kostot fillestare për materialet ekologjike mund të jenë më të larta.

4.3. Procesi i zgjerimit të linjave të produkteve

Zhvillimi i produkteve të reja të prodhimit dhe konservimit të mishit.

Avantazhet: Zgjerim i bazës së konsumatorëve dhe rritje e të ardhurave nga tregje të reja.

Disavantazhet: Kërkon investime në sisteme menaxhimi të përparuara dhe krijimin e partneriteteve të qëndrueshme me furnizuesit.

4.4. Optimizimi i zinxhirit të furnizimit

Përmirësimi i menaxhimit të furnizuesve dhe logjistikës për të siguruar lëndët e para dhe për të ulur vonesat në furnizim, mundësia e shfrytëzimit të prodhimeve vendore

Avantazhet: Ulje e kostove të transportit dhe furnizimit, përmirësim i shpejtësisë dhe efikasitetit të prodhimit.

Disavantazhet: Kërkon investime në sisteme menaxhimi të përparuara dhe krijimin e partneriteteve të qëndrueshme vendor për furnizim.

4.5. Energjia e rinovueshme

Kalimi në burime energjie të rinovueshme, si energjia diellore ose e erës, për të ulur kostot afatgjata dhe ndikimin mjedisor.

Avantazhet: Ulje e kostove të energjisë, përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore, përfitim nga stimujt qeveritarë për përdorimin e energjisë së rinovueshme.

Disavantazhet: Kosto të larta fillestare për instalimin e sistemeve të energjisë së rinovueshme.

4.6. Reduktimi i mbetjeve dhe riciklimi

Zbatimi i një sistemi të menaxhimit të mbetjeve që fokusohet në reduktimin e mbetjeve të prodhimit dhe përdorimi i mbetjeve shtazore për prodhim të ushqimit për qenë, etj.

Avantazhet: Ulja e kostove për trajtimin e mbetjeve-perfitimi nga mbetjet shtazore, përmirësimi i imazhit të markës si një kompani e përgjegjshme ndaj mjedisit.

Disavantazhet: Implementimi i një sistemi të ri mund të kërkojë trajnime dhe investime fillestare.

4.7. Trajnimi dhe zhvillimi i stafit

Investimi në trajnim dhe zhvillim profesional për punonjësit, duke përfshirë trajnim për teknologji të reja dhe praktika të mira të prodhimit.

Avantazhet: Rritja e efikasitetit dhe produktivitetit të stafit, përmirësimi i cilësisë së produkteve, ulje e gabimeve dhe ndalimeve në proces.

Disavantazhet: Kostot për trajnim dhe humbja e kohës së prodhimit gjatë periudhës së trajnimit.

4.8. Strategjia e shitjes dhe marketingut të avancuar

Përdorimi i strategjive të avancuara të marketingut dhe shitjeve për të hyrë në tregje të reja ose për të zgjeruar praninë në tregje ekzistuese.

Avantazhet: Rritje e të ardhurave, përmirësim i imazhit të markës, zgjerim në tregje ndërkombëtare.

Disavantazhet: Kosto për fushata marketingu dhe kërkim tregu.

Zgjedhja e alternativave më të arsyeshme për funksionimin e fabrikës së pecetave të lagura varet nga objektivat e kompanisë, buxheti dhe burimet në dispozicion. Disa alternativa mund të kërkojnë investime fillestare më të larta, por sjellin përfitime afatgjata, si automatizimi dhe energjia e rinovueshme. Të tjerat, si diversifikimi i produkteve dhe marketingu, mund të ndihmojnë në rritjen e menjëhershme të të ardhurave.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit në komunën e Pejës nuk është e mirë. Degradimi i tij është rezultat i ndërtimeve të pakontrolluara në zonat e mbrojtura të natyrës ashtu edhe jashtë tyre, infrastrukturës jo adekuate, shtimit të numrit të automjeteve dhe importimit të mjeteve motorike të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lart të sulfurit), deponimi i joadekuat i tyre, ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, akumulimit të mbeturinave urbane si pasojë e mos menaxhimit të mirë, riciklimit dhe trajtimit i pa mjaftueshëm i ujërave të zeza. Për më tepër, degradimi ndodhë edhe nga mihjet sipërfaqësore dhe eksploatimi i zhavorrit nga një numër i konsideruar i kompanive. Gjithashtu edhe sektori i transportit është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit dhe në cilësinë e përbërësve të tij (ajrin, ujin dhe tokën). Ai po ashtu ndikon edhe në fragmentimin dhe degradimin e habitateve, ndryshimin e peizazhit, destinimin e shfrytëzimit të tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësore, ajrit dhe dheut dhe si pasojë shkakton dëmtim të resurseve natyror dhe humbje të tokës bujqësore.

5.1. Hidrografia

Hidrografia - Rrafshi i Dukagjinit konsiderohet si treva më e pasur në Kosovë me resurse ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Komuna e Pejës ka një rrjet të zhvilluar hidrografik si lumenj, përroska, puse, liqene, burime. Duke marrë parasysh që ato mbushen nga reshjet e shiut dhe borës, sasia më e madhe e rrjedhave ujore është në vjeshtën e vonë dhe në pranverë. Lumbardhi i Pejës buron në Bjeshkët e Nemuna në më se 1.900 metra lartësi mbidetare. Në rrjedhën e vet të epërme, në Grykën e Rugovës ai është lum malor me një numër të madh kaskadash dhe rrymash të shpejta. Në rrjedhën e tij të poshtme, në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit, Lumbardhi rrjedh qetë duke krijuar shtratin e vet, i cili në disa vende arrin gjerësi deri në 200 m, dhe në Grabanicë derdhet në Drinin e Bardhë. Lumbardhi mbledh disa burime përgjatë Grykës së Rugovës si: Lumin e Boges në anën e majtë të tij dhe Lumin e Allagës në derdhjen e së cilit në Lumbardh ka kushte për ndërtimin e një akumulacioni relativisht të madh të ujit. Sipërfaqja ujëmbledhëse e Lumbardhit të Pejës është 464.8 km², me një gjatësi prej 57km, ndërsa prurja mesatare e ujit është 10,22 m³/sek. Drini i Bardhë është një nga lumenjtë më të mëdhenj, dhe ujëmbledhësi kryesor hidrografik i rrafshit të Dukagjinit, me sipërfaqe prej 4340 km², gjatësi prej 110.7 km dhe prurje mesatare të ujit 61.7 m³ /s. Buron afër fshatit Radavc, rrëzë maleve

të Zhlebit, në një lartësi mbidetare prej afër 580 metrash. Në dalje të burimit lumi krijon ujëvarë, e pastaj me zbritje relativisht të vogël, rrjedhë në një gjatësi prej afër 110 kilometrash deri në daljen e tij në Shqipëri. Sipas Master Planit për Ujëra e Kosovës 1983-2000, potencialet më të mëdha të ujërave nëntokësore gjinden në rrafshin e Dukagjinit dhe shfrytëzimi i tyre bëhet kryesisht përmes puseve dhe burimeve të cilat edhe në Komunën e Pejës janë të shumtë. Në zonën e Rugovës gjenden edhe liqenet glaciale si ai i Kuqishtës (1900 m), Liqeni i Drelajve (1800m), dhe 2 liqenet në Leqinat në lartësi prej 1860 m që shquhen për bukurinë e tyre dhe rrethinën e mbuluar me pyje të dendura pishe.

5.2. Ndotësit Kryesor

Përdorimi i drurit për ngrohje është njëri nga kontribuuesit më të mëdhenjtë të ndotjes së ajrit dhe burimi kryesor i pluhurit grimcor. Ndotësit më të mëdhenj nga zjarri i drurit janë pluhuri grimcor, karboni i zi, hidrokarburet poli-aromatike dhe dioksinat. Përveç tjerash, zjarri nga druri shkakton edhe oksidet e azotit dhe monoksidin e karbonit. Në Kosovë zjarri nga druri që përdoret kryesisht në sektorin e banimit përbën rreth 20% të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Bazuar në përllogaritjet e GAINS, sektori i banimit përbën gati gjysmën e emetime të pluhurit grimcor PM2.5 dhe pothuajse 80% të emetimeve të karbonit të zi për vitin 2015.

Komuna e Pejës, një pjesë e qytetit posedon sistem të ngrohjes qendrore, ndërsa shumica dërmuese e banorëve shfrytëzon drurin si burim të vetëm për ngrohje duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të ajrit, në veçanti gjatë periudhës së dimrit. Në masë më të vogël përdoret thëngjilli, nafta dhe gazi natyror.

5.3 Flora dhe Fauna

Në Regjionin e Pejës bënë pjesë edhe Bjeshkët e Nemuna të cilët janë ndër masivet malore më karakteristike të Ballkanit për nga pasuria floristike dhe vegjetative. Ky masiv malor radhitet ndër zonat më të pasura në Ballkan nga pikëpamja e florës dhe vegjetacionit. Në këtë rajon janë të përqendruara afërsisht 1611 specie të ndryshme bimore, prej të cilave një numër i konsiderueshëm përfshin lloje endemike, relikte dhe të rralla. Përveç kësaj, zona karakterizohet nga një prani e dukshme e bimëve shëruese, aromatike dhe mjaltëdhënëse, si dhe bimëve që rriten spontanisht dhe shërbejnë për ushqim.

Në listën e llojeve bimore të mbrojtura me UDHËZIM ADMINISTRATIV MEA - Nr. 12 /2020 PËR SHPALLJEN E LLOJEVE TË EGRA TË MBROJTURA DHE STRIKT TË MBROJTURA një përqindje e madhe ndodhen në Bjeshkët e Nemuna. Ndër llojet më të rëndësishme dhe të veçanta janë: *Pinus heldreichii* (rrobulli), *Pinus peuce* (arneni), *Pinus mugo* (kërleka), *Acer heldreichii* (panja e Heldrahut), *Acer intermedium* (pafti i Hirkanisë), *Forsythia europaea* (boshtra), *Taxus baccata* (tisi), *Alnus viridis* (vërri), *Wulfenia bleicii* (vulfenia e Bleçiçit), *Leontopodium alpinum* (luleylli), *Lilium mertagon* (zambaku trithëbota), *Gentiana lutea* (sanza), *Daphne laureola* (xerxolja dafinë), *Succisa pratensis* (suciza e livadhit).

Pyjet përbëjnë një burim të rëndësishëm ekonomik dhe turistik për këtë zonë. Këto pyje, përveç vlerave estetike, kanë rol kyç në mbrojtjen e mjedisit. Më atraktive janë pyjet halore ku mbizotërojnë llojet relikte të arnenit (*Pinus peuce*) dhe rrobullit (*Pinus heldreichii*). Arneni dhe rrobulli në Bjeshkët e Nemuna formojnë pyje të pastra dhe të përziera, shpeshherë të shoqëruara me dëllinjë dhe ah.

Arneni mund të gjendet në lartësi prej 1000 deri në 2000 metra, ndërsa rrobulli është më i zakonshëm në brezin prej 1700 deri në 2000 metra. Këto pyje, me cilësi të pyjeve të virgjëra, përfaqësojnë një rrallësi të vërtetë floristikore.

Fauna Bjeshkët e Nemuna janë të pasura me faunë të llojllojshme që përfshin gjitarë, shpendë, peshq, amfibë dhe invertebratë. Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe në bazë të shënimeve të literaturës fauna e Bjeshkëve të Nemuna përbëhet prej: 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtoksorësh, 10 lloje zvarranikësh, 148 lloje shpendësh 53 (sipas disa të dhënave më të reja 175 lloje, ndërsa mendohet të ketë mbi 200 lloje), 37 lloje gjitarësh dhe 133 lloje flutura vetëm nga rendi Lepidoptera.

Grupin e zvarranikëve në territorin e Bjeshkëve të Nemuna e përbëjnë: 5 familje me 10 lloje. Familja Testudinae me llojet: breshka e pyllit (*Testudo hermani*) dhe breshkujza (*Emys orbicularis*); familja Lacertidae me llojet: hardhuca e gjelbër (*Lacerta viridis*), hardhuca e mureve (*Podarcis muralis*) dhe hardhuca e përhimtë (*Lacerta agilis*); familja Anguidae me llojin kokëzogëza (*Anguis fragilis*); familja Viperidae me nepërken (*Vipera ammodytes*) një prej gjarpërinjëve më helmues, i cili jeton në vendet shkëmbore dhe vendet e tjera të thata. Familja Colubrinae përfaqësohet me dy lloje të gjarpërinjëve johelmues siq gjarpri i madh i ujit (*Natrix natrix*), gjarpri i vogël i shiut (*Natrix tessellata*) të cilët jetojnë përgjatë lumenjëve,

përrenjëve dhe vendqëndrimeve të tjera të ujit, si dhe bolla e shtëpisë (*Elaphe longisima*). Duhet potencuar se breshkës tokësore (*Testudo hermani*) i cili ka qenë shumë i përhapur në territorin e Bjeshkëve të Nemuna, veçanërisht në mjediset kodrinore dhe lugina, kohëve të fundit i kanoset rreziku nga zhdukja totale.

Shpendët përfaqësojnë grupin më të ndjeshëm dhe më të rrezikuar në nivel global. Në këtë zonë janë regjistruar 161 lloje shpendësh, përfshirë zhytësin gushëzezë, patat, rosat, shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonj bardhë (*Falco naumanni*), bufët, qyqet, dallëndyshet dhe qukapikët. Për shkak të kësaj pasurie, Bjeshkët e Nemuna janë cilësuar si zona me rëndësi të veçantë për shpendët (IBA - Important Bird Areas).

Gjitarët përfshijnë ariun e murmë (*Ursus arctos*), rrëqebullin (*Lynx lynx*), dhinë e egër (*Rupicapra rupicapra*), kaprollin (*Capreolus capreolus*), dhelprat (*Vulpes vulpes*), ujqërit (*Canis lupus*), derrin e egër (*Sus scrofa*) dhe lepurin (*Lepus europeus*).

Disa lloje të faunes gjenden në listën e IUCN-së (Unioni botëror për ruajtjen e natyrës), EU-RL (Lista e kuqe Europiane), ËR-RL (Lista e kuqe botërore), LKSH (Libri i kuq i Shqipërisë), LKGJ (Ligji i Kosovës për gjuetinë) etj.

Po ashtu në bazë të hulumtimeve të deritanishme dhe shënimeve të literaturës në ujrat e Bjeshkëve të Nemuna jetojnë këto lloje peshqish: trofta e përroit (*Salmo trutta m.fario L.*), trofta (*Salmo marmoratus C*), mushiku i përroit (*Barbus fluviatilis Ag.*), ngjala (*Anquilla vulgaris*), bërcaku (*Squalius cephalus L.*), krapi (*Cyprinus carpio*), mlyshi (*Esox lucius*), krapuliqi.

Faktorët që rrezikojnë biodiversitetin në këtë zonë

1. Gjuetia e paligjshme dhe pa kriter;
2. Peshkimi i paligjshëm;
3. Prerja dhe dëmtimi i pyjeve;
4. Shkatërrimi i habitateve natyrore;

5. Zhvillimi i pakontrolluar i turizmit;
6. Aktivitetet industriale dhe ndërtimet pa kriter;
7. Shkatërrimi i burimeve ujore dhe ndotja;
8. Ndikimi i ndryshimeve klimatike;
9. Zjarret dhe aktivitetet që degradojnë zonat e mbrojtura;
10. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore.

Këto faktorë janë burim kryesor i degradimit të biodiversitetit dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për të mbrojtur dhe ruajtur vlerat natyrore të kësaj zone.

5.3. Transporti rrugor

Transporti është përgjegjës për më shumë se dy të tretat e emetimit të oksideve të azotit (NO_x) dhe me përreth 10% të emetimit të përgjithshëm të ndotësve tjerë. Transporti rrugor në veçanti vazhdon të përbëj pjesën më të konsiderueshme të ndotësve kryesorë të ajrit (me përjashtim të oksideve të sulfurit). Përderisa emetimet nga transporti rrugor janë kryesisht lirime të gazrave

5.4. Mbeturinat e ngurta

Mbeturinat komunale përmbajnë një game të gjere të ndotësve, përfshirë metalet e rënda, cianidin (CN), Hidrokarburet policiklike, bifenilet e polikloruara, azbestin, metanin, amoniakun dhe hidrogjen sulfidet të cilat kanosin tokat përreth. Klasifikimi i mbeturinave bëhet sipas Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina dhe ndahen në mbeturina komunale, komerciale, industriale dhe medicinale. Ndersa sipas nivelit të rrezikshmërisë ndahen në mbeturina Inerte, të parrezikshme, dhe të rrezikshme. Mbeturinat Komunale të Pejës deponohen në deponinë regjionale në Pejë, e cila menaxhohet nga Kompania Rajonale për Mbeturina K.R.M Ambienti SH.A.

5.5. Ndotësit nga burimet agro-kemikale

Ndotësit nga burimet agro-kemikale përfshijnë fertilizuesit, plehun organik dhe pesticidet. Efektet ndotëse më të mëdha nga fertilizuesit dhe plehu organik konsiderohen të jenë futja e metaleve të rënda dhe komponimeve të tyre në dhe.

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Investimi në fabrikën e përpunimit dhe konservimin e mishit, paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për produkte e mishit që do të ofroj fabrika si dhe për mundësitë e punësimit. Ndikimet në mjedis janë shumë minimale mos të themi fare nuk kanë ndikim në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuara duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Gjatë punës se vazhdueshme të fabrikës së përpunimit dhe konservimit të mishit vjen deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga lëvizja e makinave gjatë punës, mund të krijohet zhurmë nga lëvizjet e makinave në rrugën në afërsi të fabrikës, por që nuk i tejkalon 90 dB, janë brenda standardit nga Occupational Safety and Health Administration (OSH).

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin e përfunduar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është ndërtuar objekti të cilin e shfrytëzon kompania “Mishtore Egzoni” Sh.p.k.. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

6.1. Ndikimet në ajër

Nuk ka ndikim në ajër nga Fabrika për përpunimin dhe konservimin e mishit, vetëm ndikimi në ndotjen e ajrit mund të jetë gjatë punës së transportit gjatë transportimit të mishit për në mishtore, po ashtu ka lirim minimal të aromës, sepse kompania e ka të ndërtuar me standard të lartë objektin e fabrikës.

6.2. Ndikimet në tokë

Ndërtimi dhe operimi i fabrikave mund të shkaktojë ndërprerje të shfrytëzimit të tokës madje edhe atyre pjellore. Kjo mund të çojë në humbjen e habitateve natyrore dhe në zhdukjen e specieve të kërcënuara. Përveç ndotjes së ajrit, fabrikat gjithashtu mund të kontribuojnë në ndotjen e tokës përmes shkarkimeve të ujerave të pa trajtuara. Këto emetime mund të depërtojnë në tokë dhe të shkaktojnë kontaminim të tokës dhe të pemëve. Fabrikat e përpunimit dhe, konservimit të mishit, shpesh prodhojnë sasi të mëdha mbeturinash të organike dhe

mbetjeve organike me prejardhje shtazore të cilat janë të riciklueshme dhe atë në mënyrë të efektshme, mirëpo nëse ato nuk riciklohen mund të ndotin tokën në rast të menaxhimit të pamjaftueshëm. "Mishtore EGZONI" sh.p.k, nuk shkakton ndotje në toke për shkak se ka ndërtuar impiantin e trajtimit të ujerave shkarkimi i ujërave bëhet pas trajtimit të ujerave, ndërsa në anën tjetër mbeturinat e ngurta që gjenerohen nga fabrika mbledhen nga kompania rajonale e menaxhimit të mbeturinave.

6.3. Ndikimet në ujë

Ndikimet në ujë nga fabrika "Mishtore EGZONI" sh.p.k. që përpunon, konservon mish dhe therë kafshe, mund të ndikojnë në cilësinë e ujit dhe ekosistemet përreth. Ujërat që përdoren në procese të ndryshme, nëse nuk trajtohen siç duhet, mund të shkaktojnë ndotje në lumenj dhe liqene. Përdorimi i kimikateve si konservues, aromatizues dhe agjentë pastrues për proces të prodhimit mund të shkaktojë ndotjen e ujit në rast se ato përfundojnë në sistemin ujëmbledhës, pa trajtuar. **Kompani "Mishtore EGZONI" sh.p.k., problemin e trajtimit të ujerave ka zgjidhur me ndërtimin e impiantit të trajtimit (Fig. 5).**

6.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Ndërtimi i fabrikës dhe infrastrukturës përreth mund të ndryshojë ndjeshëm peizazhin natyror, duke shkatërruar habitatet natyrore. Shkatërrimi i tokës mund të çojnë në rënien e specieve bimore lokale, duke ndikuar negativisht në biodiversitetin. Shkatërrimi i habitatit natyror për shkak të ndërtimit dhe aktiviteteve industriale mund të çojë në reduktimin e popullatave të specieve lokale. Fabrika e përpunimit dhe konservimit "Mishtore EGZONI" sh.p.k., nuk paraqet asnjë rrezik për florën dhe faunën e zonës.

6.5. Ndikimet nga zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj. Lokacioni i fabrikës "MISHTOE EGZONI" SH.P.K. me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve dhe një zhurmë të cilën e lëshon makina e përpunimit, bluarjes së mishti por e cila është brenda kufijve të lejuar,

si dhe kafshë që janë në pritje për therjes. Sipas gjendjes faktike të kompleksit në lokacionin e analizuar është konstatuar që nuk i tejkalon 90 dB. janë brenda standardit nga Occupational Safety and Health Administration (OSHA).

6.6. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

